
URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2002/13

**ZBATIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/35
MBI PENSIONET NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 34 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 të datës 22 dhjetor 2001 mbi Pensionet në Kosovë,

Duke marrë parasysh nenin 32.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 i cili përcakton datat efektive për kontributet e punëdhënësve lidhur me kursimet pensionale dhe duke u ndërlidhur me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 28 shkurt 2002 për zbatimin e Rregullores së UNMIKU-ut nr. 2001/35,

Me qëllim të ndryshimit, e në pajtim me nenin 32.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35, data efektive për kontributet e kursimeve pensionale të punëdhënësve të përcaktuara me nenin 32.3(a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35, ashtu siç kërkojnë kushtet e punës së Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1

Data efektive për kontributet e kursimeve pensionale

Data efektive e kontributeve të kursimeve pensionale që duhet t'i paguajnë punëdhënësit konform nenit 32.3(a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 do të jetë data 1 gusht 2002.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullpore hyn në fuqi më 8 qershor 2002.

Michael Steiner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm